



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

542

Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 09.02 2024

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.12

Datë: 31.01.2024

“ Për Përdorimin e Fondit Rezervë, nga Granti&Të Ardhurat ”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





562 / 16/02/24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.145/1 prot.

Peshkopi, më 14.02.2024

Lënda : Për vendimin nr.12, datë 31.01.2024 të Këshillit të Bashkisë Dibër.


BASHKISË DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.12, datë 31.01.2024 "Për përdorimin e Fondit Rezervë, nga Granti dhe Të Ardhurat", konstatova se:

Akti administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi bën pjesë në kategorinë e akteve me karakter individual për pasojë nuk është në kompetencë të Prefektit të shprehet për ligjshmërinë e kësaj vendimmarrje, veprim që kurdoherë është përgjegjësi direkte administrativo-ligjore e strukturës së posaçme të Bashkisë Dibër, që paraqet për miratim projekt akte të kësaj natyre.

Hyrja në fuqi e akteve administrative të kësaj natyre, bëhet sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenin 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM


Nr.12 Datë 31/01/2024

“Për Përdorimin e Fondit Rezervë, nga Granti&Të Ardhurat”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/ 2015, “ Për vetëqeverisjen vendore” , duke u mbështetur në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.(i ndryshuar) dhe në ligjin “Për Buxhetin e Vitit 2024” neni 15 ,pika 6 dhe ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile ” , miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.139 datë 29.12.2023, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.24/1 prot. datë 11.01.2024, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **31.01.2024**, me 24 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI

1. Nga fondi rezervë, nga Granti & të Ardhurat, t’u jepet ndihmë për raste të ndryshme:
 - Oligert Perseku **150.000** (një milion e pesëqind mijë) lekë
 - Ambra Caka **100.000** (një milion) lekë
2. Pakësohet fondi rezervë **1110** llogaria **609** në vlerën 250,000 (dyqinde e pesedhjetë mije) lekë dhe shtohet struktura **1110** llogaria **604** ne vlerën 250,000 (dyqinde e pesedhjetë mije) lekë
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomikë (Sektori i Financës), Bashkia Dibër.
4. Vendimi hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
5. Vendimi u shpall me datë **31.01.2024**.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

PROJEKT-VENDIM

NR03 Datë 30/01/2024

“Për Përdorimin e Fondit Rezervë, nga Granti & Të Ardhurat”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/ 2015, “ Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.(i ndryshuar) dhe në ligjin “Për Buxhetin e Vitit 2024” neni 15 ,pika 6 dhe ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile ”, miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.139 datë 29.12.2023, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.24/1 prot. datë 11.01.2024

VENDOSI

1. Nga fondi rezervë, nga Granti & të Ardhurat, t’u jepet ndihmë për raste të ndryshme:
 - Oligert Perseku 150.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë
 - Ambra Caka 100.000 (një milion) lekë
2. Pakësohet fondi rezervë 1110 llogaria 609 në vlerën 250,000 (dyqinde e pesëdhjete mije) lekë dhe shtohet struktura 1110 llogaria 604 ne vlerën 250,000 (dyqinde e pesëdhjete mije) lekë
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomikë (Sektori i Financës), Bashkia Dibër.
4. Vendimi hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.

Drejtoresha Ekonomike
Çeljeta ZUNA

Kryetari i Bashkisë
Rahim SPAHIU

